



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**NJOFTIM PËR MEDIAT**

**1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 36/3, të vitit 2025, në ngarkim të të pandehurve **Edison Cukaj(Gjoka)**, **Ervis Deti** dhe **Bexhed Mema**”.

**2.** Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Bib Ndreca, Engjëllushe Tahiri dhe Elsa Ulliri, me vendimin nr. **35**, datë **27.04.2026** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Edison Çukaj alias Gjoka**, për kryerjen e veprës penale të "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga nenet 245/1 paragrafi i dytë të Kodit Penal, dhe dënimit e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
- 2.** Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar i pandehuri përfundimisht me 1 (një) vit burgim.
- 3.** Në bazë të neneve **261/1/c dhe 389** të K.Pr.Penale, përshkak se kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar, urdhërohet heqja e masës së sigurimit “Arrest në burg” caktuar me vendimin **Nr. 34 datë 30.04.2025**, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nëse nuk mbahet për ndonjë masë tjetër sigurimi apo dënim penal të pavuajtur.
- 4.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervis Deti**, për kryerjen e veprës penale të "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 245/1 paragrafi i katërt dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimit e tij me 2 (dy) vjet burgim.

5. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar i pandehuri përfundimisht me 1 (një) vit e 4(katër muaj) burgim.
6. Vuajtja e dënimit fillon nga dita që ky vendim të marrë formë të prerë dhe të vuhet në një nga burgjet e sigurisë së zakonshme.
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bexhed Mema**, për kryerjen e veprës penale të "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 245/1 paragrafi i katërt dhe 25 të Kodit Penal, dhe dënimim e tij me 2 (dy) vjet burgim.
8. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar i pandehuri përfundimisht me 1 (një) vit e 4(katër) muaj burgim.
9. Bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për të pandehurin **Bexhed Mema, duke u detyruar që të mbajë kontakte me zyrën vendore të Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin i pandehuri**. Vënia në provë e të pandehurit për një periudhë kohe prej **2 (dy) vite e 8 tetë muaj**, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
10. Në zbatim të nenit 61 të Kodit Penal, detyrohet i pandehuri që gjatë kohës së provës: **a).**T'i përgjigjet thirrjeve dhe kërkesave të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës; **b).**Të marrë pëlqimin në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendbanimit.
11. Në bazë të nenit 261/1/b dhe 389 të K.Pr.Penale, urdhërohet heqja e masës së sigurimit **“Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”** caktuar me vendimin **Nr. 34 datë 30.04.2025**, të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
12. Lidhur me Provat materiale bazuar në nenin 190 të K.Pr.Penale, gjykata disponon si më poshtë ku:  
1 (një) aparat telefonik i markës “Samsung Galaxy A16”, me numër IMEI 1: \*\*\*\* dhe IMEI 2: \*\*\*\* i cili ka në brendësi kartën SIM të kompanisë italiane me numër serial \*\*\*\*, i shtetasit Edison Cukaj alias Gjoka të kthehet këtij të fundit; 1 (një) aparat telefonik i markës “Iphone 12 ProMax”, me numër IMEI 1: \*\*\*\* dhe IMEI 2: \*\*\*\* i cili ka në brendësi kartën SIM të kompanisë vodafone me numër serial \*\*\*\*, i shtetasit Bexhed Mema të kthehet këtij të fundit; 1 (një) aparat celularë i markës Samsung blu e errët model galaxy A21S në gjëndje të ndezur pa kod hyrës me nr IMEI 1: \*\*\*\* dhe IMEI 2: \*\*\*\*, sim kartë \*\*\*\*, i shtetasit Armand Tragaj të lihet në dispozicion të dosjes së ndarë; 1 (një) aparat celularë i markës Samsung galaxy A3, me nr IMEI 1: \*\*\*\* i shtetasit Ervis Deti, të

kthehet këtij të fundit.

13. Në bazë të nenit 224 të K.Pr.Penale, CD me të dhënat përkatëse, mbeten pjesë e fashikullit gjyqësor.
14. Shpenzimet hetimore si dhe ato gjyqësore (sipas proçesverbalit bashkëlidhur), ju ngarkohen solidarisht të pandehurve.
15. Kundër vendimit lejohet ankim nga palët në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

**Tiranë, më datë 28.04.2026**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**